

Territori i Shqipërisë është banuar që në lashtësi. Gjurme të jetës janë gjetur në Xare, si dhe në Shpellën e Shen Marinës në Sarandë që nga koha e Paleolitit të mesëm dhe të vonë (100 000 – 10 000 vjet me parë). Shqiptarët janë pasardhës të drejteperdrejte të Ilirëve. Fiset ilire shtriheshin në pjesën perëndimore të Ballkanit, deri në lumenjtë Sava dhe Danub në Veri, Morava dhe Vardar në Lindje (që është dhe vija kufitare me Thrakën), dhe vargmalet e Pindit në Jug dhe Juglindje (në kufi me grekët dhe maqedonasit).

Zhvillimi i shpejtë ekonomik, veçanërisht ai i metalurgjisë së bronzit dhe hekurit (në shekujt XI-V para erës sonë) krijoi bazat e kultures së përbashkët shpirtërore dhe materiale të fiseve ilire. Në fund të shekullit V p.e.s., ilirët u futën në peridhën e skllavopronarisë, dhe themeluan përgjate bregdetit qytete shumë të njohura në atë kohë, të cilat ekzistojnë dhe sot, si Durrahium (Durrësi), Apolonia, Butroti (Butrinti), Scodra (Shkodra), Lissus (Lezha), etj. Pushtimi Roman (në vitin 168 p.e.s.) pati pasoja të rënda për ilirët. Megjithatë, ata e përballuan me sukses politikën asimiluese të romaneve, kryesisht si rrjedhojë e standarteve të larta të zhvillimit dhe identitetit të kristalizuar etnik.

Pas thyrjes së romaneve në vitin 395 të erës sonë, Iliria mbeti nën sundimin e Perandorisë Bizantine. Në periudhën pasuese, Iliria u pushtua nga fise të ndryshme barbare, si Gotët, Avaret etj. Në shekujt IV - VI, sllavët pushtuan një pjesë të Ilirisë Veriore dhe Lindore, dhe Maqedonia pushtoi pjesë të cilat me vonë u asimiluan.

Fundi i mijëvjeçarit të parë shënon kristalizimin e kombit shqiptar. Me vonë, formacionet politike shqiptare të shekullit XIV mbuluan territoret nga Tivari dhe Prizreni deri në Kostur dhe Vlorë. Nderkohë, në zonën e pjesës jugore ruhej ende emri historik i Epirit, i cili në vitet pasardhëse shërbeu si sinonim për Arberinë (shumë shpesh, Heroi Kombëtar Gjergj Kastrioti Skenderbeu (1405-1468) quhej "Princi i Epirit").

Pushtimi otoman (XIV) vendosi sistemin feudal ushtarak në Arberinë (Shqipëri), por kryengritjet e njëpasnjëshme të princërve shqiptarë përparë rezistencën e madherishme të popullit shqiptar nën udhëheqjen e Heroit Kombëtar Gjergj Kastrioti, i njohur me emrin Skenderbeu. Gjergj Kastrioti Skenderbeu arriti të krijonte një shtet të centralizuar (Arberia) dhe flamuri i tij u bë flamuri kombëtar i Shqipërisë.

Shekulli XVIII shënon lulëzimin e dy "Pashalëqeve" të organizuara dhe shumë të fuqishme: Pashalëku i Bushatllinjve (me qendrën e tij në Shkodër dhe i qeverisur nga Karamahmut Pashe Bushatlliu); dhe Pashalëku i Janinës (me qendrën e tij në Janinë dhe i qeverisur nga Ali Pashe Tepelena). Lufta për pavarësi dhe identitet kombëtar arriti kulmin e saj me Levizjen e Rilindjes Kombëtare, e cila filloi më 1830.

Më 1878, kjo levizje u organizua më mirë pas Lidhjes së Prizrenit, e cila shërbeu si udhëheqja e parë ushtarake dhe politike e kryengritjeve shqiptare. Por, për fat të keq, të njëjtin vit Kongresi i Berlinit vendosi ndarjen e territoreve shqiptare, nga e cila përfituan shtetet fqinje, Mali i Zi, Serbia dhe Greqia.

Megjithatë, levizja shqiptare për liri u kurorëzua me Shpalljen e Pavarësisë, më 28 nëntor 1912. Gjate viteve të Luftës së Parë Botërore, Shqipëria u shndërrua në një betejë lufte për fuqite nderluftuese, dhe u pushtua nga Italia, Serbia, Mali i Zi, Greqia, Franca dhe Austro-Hungaria. Më 1920, Kongresi i Lushnjës (një qytet që ndodhet 90 km në jug të Tiranës), shpalli Tiranën si kryeqytet të Shqipërisë me konsensusin e përfaqësuesve nga e gjithë Shqipëria.

Më 21 janar 1925, Asambleja Kushtetuese e shpalli Shqipëri Republikë Parlamentare dhe Ahmet Zogu u zgjodh President i Shqipërisë. Por ai pati shumë pushtet, dhe Republika funksiononte më tepër si Republikë Presidenciale. Më 1 shtator 1928, Shqipëria u shpall Mbretëri Demokratike Parlamentare dhe Ahmet Zogu u shpall Mbret i Shqipërisë, duke marrë titullin mbretëror "Zogu I".

Më 7 prill 1939, Italia fashiste pushtoi Shqipëri, dhe si rrjedhim, e ashtuquajtura Asamble Kushtetuese shpalli fundin e Mbretërisë së Zogut dhe ia ofroi kurorën Viktor Emanuelit III. Shteti Shqiptar mbeti formalisht Mbretëri Kushtetuese nën sundimin e Dinastisë së Savojes. Më 29 nëntor 1944, Shqipëria u çlirua nga pushtuesit nazi-fashiste. Që nga ajo kohë, në Shqipëri sundoi regjimi komunist i Enver Hoxhës, i cili ndikoi në izolimin e vendit. Më 11 janar 1946, Asambleja Kushtetuese e shpalli Shqipëri Republikë Popullore, si një nga format e diktaturës së proletariatit, e cila zgjati pothuajse gjysëm shekulli, deri më 29 prill 1991, kur Parlamenti i parë pluralist shpalli Republikën Parlamentare të Shqipërisë.